



FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVES
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 3/2022

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 1 të Vendimit Nr.3/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Ndeshja e xhiros IV ndërmjet KB Trepça dhe KB Sigal Prishtina është shtyrë në bazë në nenit 10.1 të PG, për shkak të paraqitjes së këtyre ekipeve në gara ndërkombëtare.

II: KB Trepça ka shprehur me shkrim gatishmëri për zhvillim të ndeshjes. KB Sigal Prishtina në kërkesën për shtyrje, si arsytim ka paraqitur montimin e mungesën e stërvitjeve për shkak të punimeve në Pallatin e Rinisë dhe plan programin e trajnerit.

III: I njëjti nen (10.1) saktëson se ndeshja e shtyrë duhet të zhvillohet më së largu gjatë javës së ardhshme kalendarike (14 ditë), rrjedhimisht Komisioni i Garave ka vendosur si në dispozitiv.

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 2 të Vendimit Nr.3/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Ankesa e KB Rahoveci është e proceduar me kohë dhe me rregull.

II: Komisioni ka aranzhuar termin të video analizës, konform nenit 16.3 të PG. Pas shikimit të materialeve kontestuese në video, Komisioni i Garave konstaton se gabimet e gjyqtarëve nuk përbëjnë gabim material dhe nuk janë bazë për mos regjistrim të ndeshjes me rezultatin e arritur në fushë.

III: Lidhur me gabimet e gjyqtarëve ndihmës, Komisioni i Garave rikujton se në bazë të nenit 40 të PG, gjyqtarët ndihmës caktohen nga klubi organizator, nga mesi i personave të kualifikuar dhe licencuar (sipas rastit) për kryerjen e punëve në tavolinën zyrtare.



Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball Sponsors:

